PRISHTINA

Republika e Kosovës

N.P.L "Stacioni Autobusëve Prishtinë" sh.a

NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINE
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH. A.
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A. D.
MPE "BUS STATION" J. S.
Nr./No. 02/3525 Data/Date 22.12.2025
PRISHTINË/A

# Raporti i Punës TM3 2025

Tetor 2025

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Rr. Bill Klinton p.n., 10000 Pristine, Republika e Kosoves T: + 383 (0) 38 550 123 www.sap-rks.com info@sap-rks.com

# Përmbajtja e dokumentit


1 Informata të përgjithshme
2 Përmbledhje ekzekutive ........ 3
3 Prezantimi ........ 4
3.1. Pasqyra e strukturës organizative e ndërmarrjes ........ 4
3.1.1. Informacion i përgjithshëm lidhur me burimet njerëzore në ndërmarrje ........ 4
3.2. Organogrami ........ 4
4 Financat ........ 5
4.1. Hyrje ........ 7
4.2. Shpenzimet TM3-2025 dhe krahasimi me TM3-2024 si dhe struktura e tyre. ........ 7
4.3. Analizë e Strukturës të të Hyrave TM3 2025/2024 ........ 7
- Rritja Totale e të Hyrave ........ 10
- Kontributet Kryesore në Rritje ........ 10
- Përmbledhje Analitike ........ 10
4.4. Pasqyra e të ardhurave TM3/2025 dhe krahasimi me TM3/2024 ........ 10
5 Drejtoria e Administratës ........ 11
5.1. Zyra Ligjore ........ 11
5.2. Zyra e Burimeve Njerëzore ........ 12
5.3. Zyra e Marketingut dhe Shitjest ........ 13
6 Drejtoria e Operativës ........ 18
6.1. Shërbimi i transportit ........ 18
6.1.2. Numri i përgjithshëm i nisjeve te realizuara për kuartalin e dyte të vitit 2025 ........ 18
6.1.3. Krahasimi i nisjeve te realizuara ne 5 vitet e fundit 2020/2024 ........ 19
6.1.4. Karahsimi i numrit të biletave të udhëtimit të shituara 2024/2025 ........ 20
6.2. Raporti i punës për Shërbimin Teknik mirëmbajtja teknike ........ 20
7 Drejtoria e Shërbimeve të Përbashkëta ........ 20
7.1. Sigurimi ........ 27
7.2. Zyra e IT-së ........ 27
7.3. Zyra për Mbarëvajtjen e Proceseve të punës ........ 27
8 Prokurimi ........ 27
9 Marrëdhëniet me publikun ........ 28
10 Zyrtarë për Planifikim, Zhvillim dhe Koordinim ........ 29
10.1. Aktivitetet dhe rezultatet e arritura gjatë periudhës korrik – shtator 2025 ........ 30
10.2. Raporti mbi Vlerësimin e Tokave - 001 ........ 30
10.3. Raporti mbi Vlerësimin e Objekteve Ndërtimore - 002 ........ 31
10.4. Raporti mbi Vlerësimin e qirasë së tregut/Analizë - 003 ........ 31
10.5. Objektivat për tremujorin e ardhshëm ........ 31
10.6. Përfundimi ........ 33
........ 34

# 1 Informata të përgjithshme

| | |
|---|---|
| Emri i ndërmarrjes: | NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë |
| Shkurtesa: | SAP |
| Pronar: | Kuvendi Komunal i Prishtinës |
| Komisioni i aksionarëve: | 1. Nora KELMENDI<br>2. Gëzim SVEÇLA |
| Bordi i drejtoreve: | 1. Pajtim DEMAJ - Kryesues<br>2. Arta RAFUNA - Anëtar<br>3. Diellëza NAMANI - Anëtar<br>4. Luan HOTI - Anëtar<br>5. Veton R. PRELVUKAJ - U.D. Kryeshef Ekzekutiv |
| Kapitali i ndërmarrjes: | 11,955,624€ |
| Hapësira/ha: | 7 ha e 62 ari e 29 m². |
| Numri i peronave: | 24 |
| Numri i hapësirave afariste: | 41 |
| Te hyrat për tre mujorin e vitit 2025 | 527,248.10€ |
| Shpenzimet për tre mujorin vitin 2025 | 369,972.00€ |
| Numri i punëtoreve: | 99 |
| Mosha mesatare: | 45.84 |
| Balanci gjinor: | 60 meshkuj / 39 gra. |
| Ueb & domain | www.sap-rks.com |

## 2 Përmbledhje ekzekutive

NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë është ndërmarrje publike komunale e cila me shërbimet e ofruara ka rendësi të posaçme, që përveç se bënë lidhjen e kryeqytetit të vendit tonë me pika të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, paraqet edhe një pasqyrë të rëndësishme jo vetëm të qytetit të Prishtinës por edhe të Republikës së Kosovës në të gjitha aspektet duke filluar me atë kulturor, funksional etj.

Bazuar në skemën organizative gjatë vitit 2025 kanë qenë të punësuar 99 punëtorë, prej tyre 60 meshkuj dhe 39 gra me një moshe mesatare prej 45.84 vitesh.
Struktura organizative e ndërmarrjes është e ndare në tri (3), drejtori.
Ndërmarrja realizon të hyra vetanake dhe nuk varet nga buxheti komunal.
Burimet kryesore te të hyrave janë, shërbimi i peronizimit (pranimi dhe përcjellja e autobusëve), shërbimi i shitjes së biletave të udhëtimit për operatorët e transportit rrugorë të udhëtarëve, shërbimi i ruajtjes së bagazhit të udhëtarëve, shërbimi i parkingut për automjete, shërbimi i poligoneve për auto shkolla, qiradhënia e lokaleve afaristë në pronësi të Stacionit të Autobusëve Prishtinë.

## 3 Prezantimi

Ky raport vjetor bazohet në Ligjin mbi ndërmarrjet publike nr. 03-L-087, përkatesisht, nenin 14 dhe nenin 31.

Prandaj, bazuar në detyrimet dhe përgjegjësit, të cilat rrjedhin nga ligji mbi ndërmarrjet publike. Ky raport prezanton në mënyrë të qartë, të gjitha veprimet e ndërmarra nga ana e menaxhmentit të ndërmarrjes në drejtim të realizimit të objektivave të parashtruara për vitin 2025.

Ky raport do të prezantojë strukturën organizative të ndërmarrjes, e cila përbenë pjesën më të vlefshme të ndërmarrjes, ku dihet që, burimet njerëzore janë aseti kryesor i çdo ndërmarrjes, sepse, pa këto burime shumë vështirë do të mund të realizohen të gjitha synimet e planifikuara respektivisht, objektivat e planifikuara me qëllim që ndërmarrja të ketë suksesin e synuar.

Çështjet juridike kanë rëndësi të veçantë për ndërmarrjen, si rrjedhojë të njëjtat kanë ndikim të madhe në suksesin e ndërmarrjes prandaj, do të behet prezantimi i të gjitha veprimeve të ndërmarra që ndërmarrja të operoje në një ambient sa më të mirë të punës duke u bazuar në ligjet dhe rregulloret në fuqi.

### 3.1. Pasqyra e strukturës organizative e ndërmarrjes

#### 3.1.1. Informacion i përgjithshëm lidhur me burimet njerëzore në ndërmarrje

NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë, ka Bordin Drejtues (BD), në kuadër te të cilit vepron edhe Komisioni i Auditimit të zgjedhur nga komuna e Prishtinës, e cila është aksionar i ndërmarrjes, Kryeshefin Ekzekutiv (KE), Sekretarin, Zyrtarin Kryesore Financiar dhe të Thesarit (ZKFTH) të zgjedhur nga BD-ja si dhe Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm (ZAB) të zgjedhur nga komisioni i auditimit.
Bazuar në skemën organizative gjatë vitit 2025 kanë qenë të punësuar 99 punëtore, prej tyre, 60 burra dhe 39 gra me një moshe mesatare prej 45.84 vitesh.
Bazuar në Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, të datës 31.01.2025, me numër protokolli 02/147, struktura organizative e

ndërmarrjes është e ndare në tri (3), drejtori, staf mbështetës të KE-së, sektori ekonomiko-financiar dhe zyra e Prokurimit.

1. Stafi mbështetës i KE-se;
2. Drejtoria e Administratës
3. Drejtoria e Operatives
4. Drejtoria e Shërbimeve te Përbashkëtat,
5. Departamenti ekonomiko – financiar, i përberë nga:
   5.1. Shërbimi i kontabilitetit
   5.2. Shërbimi financiar, dhe
   5.3. Shërbimi i pagesave,
6. Zyra e Prokurimit;

## 3.2. Organogrami




NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Rr. Bill Klinton p.n., 10000 Pristine, Republika e Kosoves T: + 383 (0) 38 550 123 www.sap-rks.com info@sap-rks.com

# 4 Financat

## Raporti financiar Korrik-Shtator 2025

### 4.1. Hyrje

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, konkretisht nenin 14 që rregullon obligimin për raportime financiare periodike, sektori financiar i NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. – Prishtinë ka përgatitur raportin financiar për Tremujorin e Tretë të vitit 2025 (Korrik – Gusht – Shtator).

Ky raport ka për qëllim të paraqesë performancën financiare të ndërmarrjes për periudhën e lartpërmendur, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, si dhe krahasimin me të njëjtën periudhë të vitit paraprak (TM3/2024). Këto të dhëna i ndihmojnë menaxhmentit në procesin e vlerësimit të performancës dhe planifikimit strategjik për zhvillimin e mëtejshëm të ndërmarrjes.

### 4.2. Shpenzimet TM3-2025 dhe krahasimi me TM3-2024 si dhe struktura e tyre.

Krahasimi i shpenzimeve është bërë për periudha të njëjta të viteve 2025 dhe 2024, përkatësisht për Tremujorin e Tretë (Korrik – Gusht – Shtator ). Të dhënat janë marrë nga evidencat e kontabilitetit dhe, si të tilla, paraqiten në tabelën më poshtë.

| Përshkrimi | TM3/2025 | TM3/2024 | Shkalla e uljes/rritjes % | Struktura e Shpenzimeve % |
|---|---|---|---|---|
| SHPENZIMET E ENERGJISE ELEKTRIKE | 3,793.12 | 1,236.77 | 206.70 | 1.03 |
| KOSTO E BILETAVE TE PERJASHTUARA | 85,363.05 | 89,360.29 | (4.47) | 23.07 |
| SHPENZIMET E PAGAVE | 243,207.54 | 210,665.17 | 15.45 | 65.74 |
| SHPENZIME PER KONTRIBUTE PENSIONAL – PUNEDHENESI | 12,160.38 | 10,533.26 | 15.45 | 3.29 |
| SHPENZIMET KOMUNALE TE UJIT | 1,920.17 | 2,090.00 | (8.13) | 0.52 |
| SHPENZIMET E MBETURINAVE | 2,269.45 | 6,156.83 | (63.14) | 0.61 |
| SHPENZIMET E TELEFONIT | 420.56 | 463.3 | (9.23) | 0.11 |
| SHPENZIMET E INTERNETIT | 214.83 | 706.78 | (69.60) | 0.06 |
| PROVIZION BANKAR | 376.17 | 369.8 | 1.72 | 0.10 |
| SHPENZIMET E REPREZENTACIONIT TE KE-S | 793.15 | 827.97 | (4.21) | 0.21 |
| SHPENZIMET E DERIVATEVE | 286.45 | 248.6 | 15.23 | 0.08 |
| SHPENZIMET AD HOC | 878.15 | 778.74 | 12.77 | 0.24 |
| SHPENZIMET PËR SHPALLJE / REKLAMA, LLOGO | 415.93 | 59 | 604.97 | 0.11 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| SHPENZIME PER MIREMBAJTJE TE HAPSIRAVE GJELBERUESE | 8,135.98 | 320.56 | 2,438.05 | 2.20 |
| SHPENZIMET E MIRËMBAJTJES SË ARKAVE FISKALE | 163.56 | 98.73 | 65.66 | 0.04 |
| SHPENZIMET PAISJE PËR IT | 184.95 | 244.91 | (24.48) | 0.05 |
| SHPENZIMET E MIREMBAJTJES SE OBJEKTIT | 716.69 | 94.5 | 658.40 | 0.19 |
| SHPENZIMET E MIREMBAJTJES SE MAKINAVE | 190.19 | 41.36 | 359.84 | 0.05 |
| MIRËMBAJTJE DHE FURNIZIM ME SISTEM TË SHITJES SË LAURAVE | 2,441.01 | 1,828.49 | 33.50 | 0.66 |
| SHPENZIMET PËR UJË TË PIJES | 354.89 | 260.62 | 36.17 | 0.10 |
| SHPENZIMET E SANITARISË | 442.29 | 126.69 | 249.11 | 0.12 |
| SHPENZIMET E MIRËMBAJTJES SË HOLLIT | 2,524.83 | 0.01 | N/A | 0.68 |
| SHPENZIMET PËR UNIFORMA | 64.44 | 0.01 | N/A | 0.02 |
| VLERESIMI I PRONAVE TE PALUJTSHME,QIRASE SE TREGUT | 1,251.69 | 0.01 | N/A | 0.34 |
| SHPENZIMET PER VLERSIM TE KENAQSHMERISË SË KONSUMAOTRIT | 888.98 | 0.00 | N/A | 0.24 |
| ASGJESIMI I ASETEVE | 513.53 | 0.01 | N/A | 0.14 |
| SHPENZIMET E PROGRAMIT TE SISTEMIT TE DIGJITALIZIMIT | 0.01 | 865.75 | N/A | 0.00 |
| SHPENZIMET PËR PËRMBARUES PRIVAT | 0.01 | 2,374.65 | N/A | 0.00 |
| **Totali i shpenzimeve TM3 2025/2024** | **369,972.00** | **329,752.81** | **12.20** | **100.00** |

Pikat kyçe të raportit të shpenzimeve TM3/2025-TM3/2024

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025, shpenzimet totale arritën në 369,972 €, duke shënuar një rritje prej rreth 12.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 (329,752.81 €).

Analiza e strukturës së shpenzimeve tregon disa zhvillime të rëndësishme

1. Pesha kryesore e shpenzimeve – Pagat dhe beneficionet (69% e totalit)

Shpenzimet për paga (243,207.54 €) dhe kontribute pensionale (12,160.38 €) përbëjnë mbi 69% të të gjitha shpenzimeve, duke mbetur kategoria dominues e kostove operative. Ka një rritje të pagave prej rreth 32,500 €, që është ndikuesi kryesor i rritjes totale të kostove,Shpenzimet e biletave të përjashtuara – 23% e totalit. Rritje të theksuara në disa kategori operative.Disa shpenzime operative kanë shënuar rritje të lartë, duke ndikuar ndjeshëm në diferencën totale.Mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese-nga 320.56 € në 8,135.98 € – një rritje shumë e madhe, duke përfaqësuar 2.20% të totalit.Mirëmbajtja e objektit-nga 94.50 € në 716.69 € – një rritje mbi 650%.Mirëmbajtja e sistemit të shitjes së laurave nga 1,828.49 € në 2,441.01 €, përfaqëson 0.66% të totalit, shpenzimet e mbeturinave nga 6,156.83 € në 2,269.45 €, në këtë rast me ulje të konsiderueshme, por mbeten brenda kategorive më të dukshme operative,shpenzimet teknike dhe të infrastrukturës

Shpenzimet për IT, internet, pajisje dhe arkë fiskale kanë mbetur në nivel minimal (rreth 1% të totalit), duke sugjeruar stabilitet dhe kontroll të mirë të kostove teknike.

Shpenzime të vogla, por me devijime nga viti 2024. Ka kategori ku vitin e kaluar kishte shpenzime relativisht të larta, ndërsa në 2025 pothuajse janë zero, p.sh.:

- Shpenzimet për përmbarues privat: nga 2,374.65 € → 0 €
- Shpenzimet e sistemit të digjitalizimit: nga 865.75 € → 0 €
- Shpenzimet e sanitërisë, uniformave dhe vlerësimit të konsumatorëve – mbeten në nivele të ulëta, por prezente.

Kjo tregon optimizim të kostove në disa zëra jo-kritikë. Struktura e shpenzimeve – qëndrueshmëri dhe ndryshime

- 65.73% e totalit – Pagat
- 23.07% – Biletat e përjashtuara
- 11.20% – Të gjitha kategoritë e tjera të operimit

Kjo strukturë tregon se kompania mbetet e orientuar drejt shpenzimeve të personelit, me rritje të vogla ose të moderuara në shumicën e kategorive tjera.

### 4.3. Të hyrat për periudhën TM3-2025

Të hyrat janë të bazuara në të dhënat e evidentuara nga kontabiliteti dhe, si të tilla, paraqiten më poshtë. Krahasimi i të ardhurave është bërë për periudha të njëjta të viteve 2025 dhe 2024, përkatësisht për TM3-2025

Paraqitja Tabelare e te Hyrave per periudhen TM3-2025 në krahasim me TM3-2024

| Përshkrimi | 2025 | 2024 | Shkalla e Realizimit % | Struktura e Shpenzimeve |
|---|---|---|---|---|
| TE HYRAT NGA BILETAT E PERJASHTUARA | 104,041.50 | 114,704.50 | (9.30) | 19.73 |
| TE HYRAT NGA SHERBIMI BILETAVE | 3,744.92 | 4,069.92 | (7.99) | 0.71 |
| TE HYRA NGA QERAJA MUJORE UJI | 1,468.84 | 1,611.06 | (8.83) | 0.28 |
| TE HYRAT NGA PARKINGU | 130,520.44 | 96,902.47 | 34.69 | 24.76 |
| TE HYRAT NGA PERONIZIMI | 242,480.08 | 168,527.96 | 43.88 | 45.99 |
| TE HYRA NGA GARDEROBA | 1,253.81 | 851.27 | 47.29 | 0.24 |
| TE HYRAT NGA TARIFA A1, A2 | 29.31 | 39.15 | (25.13) | 0.01 |
| TE HYRAT NGA QERAJA POLIGONIT | 423.73 | 635.6 | (33.33) | 0.08 |
| TE HYRAT NGA SHP. KANALIZIMIT | 176.66 | 206.58 | (14.48) | 0.03 |
| TE HYRAT E QERASE MUJORE | 35,374.91 | 39,754.64 | (11.02) | 6.71 |
| TE HYRAT E TERASAV | 4,091.39 | 4,164.36 | (1.75) | 0.78 |
| TE HYRAT NGA REKLAMAT VJETORE | 338.98 | 677.97 | (50.00) | 0.06 |
| TE HYRAT NGA NDERRIMI I TARGAVE | 97.46 | 59.32 | 64.30 | 0.02 |
| HYRJA TEK PERONI | 144.07 | 322.03 | (55.26) | 0.03 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| TE HYRAT NGA DEMTIMI I LAURES | 3,062.00 | 0.01 | N/A | 0.58 |
| **Totali i të hyrave TM3 2025/2024** | **527,248.10** | **432,526.82** | **21.90** | **100.00** |

### 4.3. Analizë e Strukturës të të Hyrave TM3 2025/2024

Ky dokument përmbledh analizën e ndryshimeve në të hyrat e Stacionit të Autobusëve për TM3 2025 krahasuar me TM3 2024.

**- Rritja Totale e të Hyrave**

- TM3 2025: 527,248.10 €
- TM3 2024: 432,526.82 €
- Rritja totale: 94,721.28 €
- Përqindja e rritjes: ~21.9%

**- Kontributet Kryesore në Rritje**

Arsyet e rritjes ne peronizim dhe ne parking eshte nga Rritja e tarifave per keto kategori te sherbimit ndersa zvoglimi eshte per shkak te largimit te disa qeragjinjeve dhe disa vonesa te vogla ne faturimin e qerave ne muajin 09-2025 ne periudhen e ripertritjes se kontrates kjo reflektohet me rritje te te hyrave ne muajin tetor 2025 respektivisht ne tm4-2025

| Zëri | Ndryshimi (€) | Kontributi në rritje |
|---|---|---|
| Peronizimi | +73,952.12 | 78% |
| Parking | +33,617.97 | 35% |
| Qeraja mujore | -4,379.73 | Negativ |
| Biletat e përjashtuara | -10,663.00 | Negativ |

**- Përmbledhje Analitike**

Rritja totale prej 21.9% dominohet kryesisht nga dy burime:

- Peronizimi kontribuon 78% të gjithë rritjes.
- Parkingut i takojnë 35% të rritjes.

Zërat me rënie të të hyrave (qeraja mujore, biletat e përjashtuara) e kanë ulur disi efektin por nuk e ndryshojnë pamjen e përgjithshme pozitive.

Përmirësimi i menaxhimit të peronizimit dhe parkingut duket të jetë burimi kryesor i rritjes së të hyrave në TM3 2025.

### 4.4. Pasqyra e të ardhurave TM3/2025 dhe krahasimi me TM3/2024

NPL"Stacioni I Autobusëve"Sh.A,prishtinë
NRF:600118245
NU: 811318741

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
për tremujorin që përfundon më 30 Shtator 2025

| | TM3 2025 | TM3 2024 |
|---|---|---|
| | € | € |
| Të hyrat | 527,248.10 | 432,526.82 |
| Kostoja e shitjes | -85,363.05 | -89,360.29 |
| Fitimi/(humbja)bruto | 441,885.05 | 343,166.53 |
| Të ardhurat e tjera | | |
| Shpenzimet e shpërndarjes të pagave | -255,367.94 | -221,198.43 |
| Shpenzimet administrative | -4,053.61 | -3,991.04 |
| Shpenzimet e tjera operative | -25,187.40 | -15,203.01 |
| Shpenzimet e zhvlerësimit | - | - |
| Fitimet /humbjet tjera - neto | - | - |
| Të Shpenzime | -284.608.95 | -240,392.48 |
| Fitimi/(humbja) operativ | 157,276.10 | 102,774.05 |
| **Fitimi para tatimit** | **157,276.10** | **102,774.05** |
| Shpenzimet e tatimit në fitim | - | - |
| Fitimi/(humbja)i/e vitit | | |
| Gjithësej të ardhurat/(humbjet)gjithëpërfshirëse të vitit | 157,276.10 | 102,774.05 |

Pasqyra e të ardhurave paraqet përmbledhjen e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën përkatëse të viteve 2025 dhe 2024. Nga analiza rezulton se në vitin 2025, në raportin TM3, kemi një fitim operativ prej 157,276.10€, ndërsa në vitin 2024, në të njëjtin raport, fitimi operativ ka qenë 102,774.05€. Diferenca midis TM3 për vitin 2025 dhe TM3 për vitin 2024 është 54,502.05€.

Shpenzimet për zhvlerësim dhe shpenzimet akruale nuk janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave për periudhën Korrik-Gusht-Shtator të viteve 2025 dhe 2024.

## 5 Drejtoria e Administratës

Drejtoria e Administratës në fokusin dhe detyrat kryesor ka bërë menaxhimin e punës më efikase, shkresave kërkesave sipas nevojës së procesit të punës dhe vendimet cilat janë kryer në afat dhe me përkushtim për arritjen e rezultateve maksimale në afarizmin e përgjithshëm të ndërmarrjes nga zyra e Burimeve Njerëzore , zyra Ligjore, zyra e Arkives, zyra e Protokolit, zyra e Recepcionit dhe zyra për Mbrojtje dhe Siguri në punë.

## 5.1. Zyra Ligjore

Raporti i punës përfshinë aktivitetet e Zyrtarit Ligjor gjatë periudhës Korrik, Gusht dhe shtatorë 2025.

Detyrat dhe përgjegjësit e punës së Zyrtarit Ligjor janë të parapara me rregulloren për sistematizimin dhe përshkrimin e detyrave të punës.

Të gjitha aktivitetet e Zyrtarit Ligjor , si për periudhën e raportimit dhe periudhave tjera bazohen ne rregulloren e sipër cituar dhe akteve tjera Ligjore e nen ligjore.

Zyra Ligjore kujdeset në vazhdimësi që aktet e ndërmarrjes (departamenti juridik) të jenë të harmonizuara me legjislacionin në fuqi.

Sipas kërkesave dhe nevojave Zyra ligjore benë draftimin e akteve vendimeve që ndërlidhen me aktivitetet dhe mbarëvajtjen e procesit të punës në ndërmarrje.

Gjatë periudhës së raportimit, Zyra Ligjore ne bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore ka qene e angazhuar në draftimin e kontratave për themelimin e marrëdhënies së punës, për punëtorët e ndërmarrjes. Gjithashtu ndërmarrja ka filluar procesin e rekrutimit dhe me kërkesë te menaxhmentit Zyra Ligjore është kujdesur te bëjë draft vendimin për shpallje te konkursit për 5 pozita të lira të punës.

Menaxhmenti i ndërmarrjes gjatë periudhës së raportimit bazuar ne ndryshimin e rregullores për dhënien e hapësirave afariste me qira, ka ndërmarr veprime administrative procedurale në funksion te harmonizimit dhe vazhdimit te kontratave të qirasë, sipas ndryshimeve te aprovuara te rregullores. Në kuadër te kësaj Zyra Ligjore ne koordinim te vazhdueshëm me Zyrën për planifikim zhvillim dhe koordinim kane qene te angazhuar ne draftimin e njoftimeve për te gjithë qiramarrësit.

Zyra Ligjore me kërkesë dhe sipas udhëzimeve te UD Kryeshefit Ekzekutiv, ka draftuar vendimet lidhur me ankesat, kërkesat e qiramarrësve lidhur me njoftimin e lëshuar nga qiradhënësi.

Po ashtu, Zyra Ligjore ne koordinim me Zyrën për Planifikim Zhvillim dhe Koordinim, kanë qenë të angazhuar ne draftimin e formës se kontratës për qiradhënie.

Zyra Ligjore me kërkesë te UD Kryeshefit Ekzekutiv gjatë periudhës së raportimit ka qene e angazhuar në koordinimin e nënshkrimit te marrëveshjes për furnizim me energji elektrike, Si rezultat NPL Stacioni i Autobusëve sh.a Prishtine me datë 15.08.2025 nënshkruan marrëveshjen për furnizim me energji elektrike, me Korporatën Energjetike të Kosovës. Marrëveshje. Kohëzgjatja e marrëveshjes është 3 (tre) muaj, nga data 16.08.205 deri me datë 15.11.2025.

Sipas Autorizimit zyra ligjore përfaqëson ndërmarrjen në kontestet gjyqësore.

Gjatë kësaj periudhe zhvilluar seanca për kontestin civil:

1. Ke.nr.222/23 – seancat gjyqësore të zhvilluara dt. 09.07.2025 Lënda ende është në proces.

Bazuar ne aktvendimi e gjykatë C.nr. 2020/22 me te cilin aprovon propozimin e paditësit për ekspert financiar, zyra ligjore është kujdesur qe ekspertit financiar te i vë në dispozicion informatat e kërkuara sipas kërkesës se ekspertit. Lënda ende është në proces, seanca e radhës është ftuar me datë 11.11.2025.

Në vazhdën e procesit te ripërtëritjes së kontratave të qirasë me subjektet afariste te cilat veprojnë ne hapësirat e ndërmarrjes, gjatë këtij procesi nga zyra ligjore është draftuar përgjigje për Auto Taxi, po ashtu nga zyra ligjore është draftu vendimi për ndërprerje te kontratës me ENNUI sipas kërkesës se vetë qiramarrësit.

Gjatë kësaj periudhe Zyra Ligjore ka përgatitur draft njoftimin sipas Raportit Zyrtar nr.02/1850 datë 09.09.2025 të hartuar nga Inspektorati i Punës lidhur me rastin e Shefki Rexhepit.

Raste në gjykatë (seanca gjyqësore) gjatë muajit Shtator nuk janë zhvilluar.

Nga Data 15.09.2025 deri me datë 29.10.2025 kur i'u është ndërpre pushimi vjetor 29.10.2025 nga ana e punëdhënësit. Arsyeja e ndërprerjes, rregullimi i draft kontratave pasi është vërejtur se në tekstin e kontratës se qirave ka qene e përfshirë një dispozitë ligjore e shfuqizuar.

Menjëherë pas kthimit nga pushimi vjetor Zyrtari Ligjor është angazhuar për rregullimin e kontratave te qirasë dhe përshtatjen e tyre sipas udhëzimeve të marra nga menaxhmenti ne përputhshmëri me qiraxhinjtë qe figurojnë që janë në borxhe dhe qiraxhinjë qe nuk kanë borxhe po ashtu edhe te qiraxhinjtë te njohur për ndërmarrjen, kontratat për sportele

### 5.2. Zyra e Burimeve Njerëzore

Zyra e Burimeve Njerëzore përgjatë këtyre tre muajve korrik,gusht dhe shtator 2025, kishte këtë rrjedhoje pune:

Arritjet

1. Rekrutimi:

Pergjatë muajit korrik 2025 vazhduan procedurat e rekrutimit për pozitat e shpallura sipas vendimeve nr.02/992 dt.11.06.2025 dhe vendimit nr.02/1057 dt.19.06.2025.Ndërsa ne muajin gusht 2025 pas përfundimit të procedurave të rekrutimit për pozitat e shpallura sipas vendimeve nr.02/992 dt.11.06.2025 dhe vendimit nr.02/1057 dt.19.06.2025, në ndërmarrje u evidentuan edhe këto pruarje te reja si në vijim:

1. Asistent i zyrës ligjore – 1 pozitë pune –
2. Mirëmbajtës i Higjienës dhe Hapësirave Gjelbëruese – 4 pozita pune,.
3. Udheheqes i Shërbimit Teknik dhe mirëmbajtejes - 1 pozitë pune – punëtor i ri
4. Arkatar – 3 pozita pune, të punësuarit e rinjë:
5. Punëtor i sigurimit dhe
6. Teknik i Teknologjise Informative pas përfundimit të procedurave të rekrutimit u shpallën si kandidatët më të suksesshëm dy punëtor të cilët janë aktualisht në marrëdhënie pune në Ndërmarrje .

Të gjithë të lartpërmendurit lidhën kontratë pune për afat te pacaktuar me Ndërmarrjen, duke inkorporuar edhe afatin e punës praktike të përcaktuar sipas Rregullores për themelimin e marrdhënies së punës në Ndërmarrjen Publike Stacioni i Autobusëve sh.a Prishtinë.

Ndërsa pas përfundimit te procedurave të rekrutimit nga ana e Bordit të Drejtorëve për pozitën e punës: Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit (ZKFTH), në fund të muajit gusht 2025,

Si rezultat i miratimit të rregullorës **"Rregullore mbi pagat dhe kompenzimet tjera në NPL"SAP" Prishtinë nr.02/1405 dt.31.07.2025"**, si dhe vendimit për përpilimi e kontratave të reja mbi themelimin e marrëdhënies së punës me nr prot:02/1510 dt:11.08.2025,në muajin gusht dhe shtator 2025 u përgaditen Kontratat e reja të punës për të gjithë punëtorët e Ndërmarrjes, përjashtimisht dy rasteve të punëtorëve (Fitore Murati dhe Fatmir Bislimi) poashtu edhe sipas Rregullore për organizimin e brendshëm, sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës nr.02/147 dt.31.01.2025, u riforumuluan (i'u ndryshua thirrja e pozitës së punës) edhe pozitat e punës si në vijim :

1. "Bashkpunetor ne prokurim" i riformulohet pozita e punës në **"Zyrtar i prokurimit"**.
2. "Asistent i Burimeve Njerëzore" i riformulohet pozita e punës në **"Bashkpunëtor i Zyrtarit të Burimeve Njerëzore"**.
3. "Përgjegjës për Marrdhëdhënie me klient" i riformulohet pozita e punës në **"Zyrtare për marrdhënie me klient"**.
4. "Kontrollues i arkave fiskale dhe Z-raporteve" i riformulohet pozita e punës në **"Zyrtar i kontrollës së Arkave Fiskale dhe Z-raporteve"**.
5. "Mbikqyres i kamerave" i riformulohet pozita e punës në **"Mbikqyresi i CCTV-së"**.
6. "Udhëheqës i sigurimit të aseteve" i riformulohet pozita e punës në **"Zyrtar përgjegjës i sigurimit"**.
7. "Kontroll Financiare" i riformulohet pozita e punës në **"Kontrollor i Sistemit dhe Financave"**.
8. "Garderobist" i riformulohet pozita e punës në **"Nënpunës në Garderobë"**.
9. "Mirëmbajtës Higjeniko Sanitare dhe Hapsirave Gjelbëruese" i riformulohet pozita e punës në **"Mirëmbajtës i Higjenës dhe Hapsirave Gjelbëruese"**.
10. "Punëtor në zyrën e informimit vizuel" i riformulohet pozita e punës në **"Nënpunës ne Informaten fonike dhe Vizuele(pirgu)"**.
11. "Teknik i Transportit" i riformulohet pozita e punës në **"Zyrtar i transportit"**.

Ndersa, gjatë muajit **shtator 2025**, konkretisht me dt.10.09.2025, Zyra e Burimeve Njerëzore ishte e angazhuar me procedurat e rekrutimit fillimisht të shpalluar sipas vendimit nr.02/1877 dt.10.09.2025, për pozitat e punës: kordinator I Nderrimit(1 pozitë pune),Punëtor në mirëmbajtjen e objekteve dhe asetetve (1 pozitë pune), Dispicer I peronave(1 pozite pune), Biletar (1 pozite pune)dhe Nëpunës në Garderobë(1 pozitë pune). Konkurset u shpallën me dt: 11.09.2025 dhe ishin të hapura deri me dt:25.09.2025 në orën 16:00h.

## 2. Sistemimet e përkohshme

Në funksion të mbarvajtjes së procesit të punës dhe konform dispozitave ligjore të cilat rrjedhin nga ligji i punës nr.03/L-212 si dhe Rregullores për themelimin e marrdhënies së punës në NPL SAP nr.02/308 dt.04.03.2025, në këta muaj u realizuan edhe sistemimet e punëtorëve si në vijim.

Për shkak të mungesës së stafit të punëtorëve në pozitën e punës si: Kordinator i Ndërrimit për shkak të pensionimit të punëtorit i cili ka ushtruar këtë detyre, si dhe për shkak të mungesës së punëtorëve në pozitën e punës "Teknik i Teknologjisë Informative", u sistemuan përkohesisht punëtorë si në vijim:

1. **Erhan Qerka** u sistemua për 30 ditë pune nga pozita e punës "Punëtor në mirëmbajtjen e objekteve dhe aseteve" në pozitën e punës "Teknik I IT-së", nga dt.11.07.2025 deri me dt.14.08.2025.
2. **Demush Abazi** u sistemua për 30 ditë pune nga pozita e punës "Dispiçer i peronave" në pozitën e punës "Kordinator I ndrrimit", nga dt.11.07.2025 deri me dt.21.08.2025.

Poashtu për shkak të procedurave të rekrutimit dhe kërkesa ligjore që burojn nga Rregullorja nr.02/308 dt.04.03.2025 dhe procedurave të hapura të rekrutimit, përgjatë kësaj periudhe kohore u sistemuan përkohësisht punëtor edhe në pozitat e punës: "Zyrtar Ligjore", "Zyrtar i burimeve njerezore".

3. **Lirije Krasniqi** u sistemua përkohësisht për 30 ditë pune nga pozita e punës "Bashkpunëtor i Zyrtarit të Burimeve Njerëzore " në pozitën e punës "Zyrtar e Burimeve Njerëzore" nga dt.14.08.2025 dhe zgjatë 30 ditë pune.
4. **Donjeta Krasniqi** u sistemua përkohësisht për 30 ditë pune nga pozita e punës "Asistente e Ud.Kryeshefit Ekzekutiv " në pozitën e punës "Zyrtare Ligjore" nga dt.14.08.2025 dhe zgjatë 30 ditë pune.
5. **Bedrije Mjeku** me detyrat e punës **"Sekretare Korporative"** u caktua Ud.Kryeshefe Ekzekutive nga dt:12.08.2025 deri me dt:01.09.2025. Vendimi me nr.02/1485 datë:08.08.2025(për shkak se Ud.Ke Veton Prelvukaj ishte ne shfrytezim të pushimit vjetor)

3. **Pensionimet**

- **Pensionim sipas bazes ligjore**: Përgjate kësaj periudhe korrik,qershor dhe shtator 2025, nuk ka pas raste te shkuarjes në pension.
- **Pensionimet e parakohshme**: Raste të penisonimeve të parakohshme nuk kemi pasur. Perjashtimisht një punëtore e cila ndodhet në pensionim të parakohshëm nga vitet e kaluara, në pozitën e punës "Likuidator".

4. **Shkëputja e marrdhënies së punës:** Përgjatë kesaj periudhe kohore korrik,gusht dhe shtator 2025,nuk ka pasur ndonje rast te evidentuar.

5. **Përllogaritja e stazhit të punës 0.5%**

Në fillim të muajit janar(vendimi nr.02/28 dt:09.01.2025) sikurse viteve tjera është marr vendim që stazhi i punës të përllogaritet për të gjithë punëtoret e ndërmarrjes sipas të dhënave se në cilin muaj kanë krijuar marrdhënien e punës në Ndërmarrje. Prandaj në muajin korrik,gusht dhe shtator 2025 bazuar në vendimin e lartcekur, stazhi i punës u përllogarit për punëtorët si në vijim:

6. **Masa disiplinore**. Sa i përket shqiptimit të masave disiplinore përgjatë kësaj periudhe kohore korrik-gusht nuk kemi pasur ndonjë shqiptim të masave disiplinore përjashtmisht ajo nga muaji qershor 2025 shqiptimi i masës disiplinore - Suspendim i përkohshëm nga puna për punëtorin i cili ushtron pozitën e punës "Ndihmës i koordinatorit të shërbimit teknike"- z.Shefki Rexhepi,i cili vazhdonte të jetë i suspenduar dhe ndaj të cilit edhe është ngritur Fletëparaqitja disiplinore me nr. nr.02/1470 datë: 07.08.2025.

**Komisioni disiplinor:** në muajin korrik 2025 me vendim u themelua edhe komisioni i ri disiplinor me nr prot:02/1313 dt:18.07.2025, në përbërje të 3 anetarve:

1. Blerta Jashanica – Kryetare e Komisionit,
2. Lirije Krasniqi –Anetre e Komisionit dhe
3. Bujar Meha –Anetare I Komisionit .

**Masat disiplinore- përgjatë muajit Shtator 2025.** Përgjatë këtij muaji komisioni disiplinore trajtoj rastin e z.Shefki Rexhepi dhe nxjerri edhe rekomandimin me nr. nr.02/1981 dt:22.09.2025. Pas trajtimit dhe shqyrtimit të rastit të z.Shefki Rexhepi të njejtit l'u shqiptua masa **Vërejtje me shkrim**- Vendimi me nr.02/2004 dt.23.09.2025.

7. **Pushimet**

7.1. Pushimet vjetore, mjekësore dhe mungesat tjera edhe në korrik, gusht dhe shtator 2025, rëndom sikurse muajve paraprak ZBNJ përgjatë këtyre muajve arritën të hartojn, evidentoj dhe monitoroj në koordinim me udhëheqësit e tyre paraprak realizimin e pushimit vjetor. Në këtë periudhë kohore për pushim vjetor u shfrytëzuan ditët nga pushimi vjetor nga ky vit aktual 2025, përjashtimisht 6 punëtor të cilët kanë bartur pushimin nga viti i kaluar 2024 pasiqë atyre fillimisht i'u ishte refuzuar kërkesa për shfrytëzimin e pushimit vjetor. Në mënyrë të detajuar do pasqyrohet ne tabelat si në vijim.

**Vërejtje:** Çdo mungesë e paarsyetuar në orarin e punës, në vendin e punës do zbatohet në mënyrë të menjëhershme në ditë të pushimit vjetor.

*7.2.* Ndërsa pushim mjeksor nga 97 punëtor sa numron Ndërmarrja aktualisht në këta muaj kanë shfrytëzuar punëtoret e pasqyruar si në tabelat e mëposhtne: 20 26 23

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Sheqir Abazi | 14.07.2025 | 18.07.2025 | 5 ditë te lira |
| 2 | Shukri Demolli | 04.09.2025 | 09.09.2025 | 2 ditë të lire |

*7.4.* Poashtu në këtë periudhe kohore është evidentuar vendimi mbi shfrytezimin e pushimit te lehonise sipas dispozitave ligjore ne fuqi për zonjën Fitore Muarti Thaqi, vendimi mban nr prot:02/1211 dt:08.07.2025.

7. 4 Ndërsa, sa i përket pushimeve tjera, në këtë muaj ka qenë një punëtore për rastin e vdekjes së antarit të ngusht të familjes – Nënës.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Besarta Leci | 08.09.2025 | 12.09.2025 | 5 ditë |

<u>8. Vendimi nga Ministria e Shendetesise.</u> Vendimi i nxjerrur nga Ministria e Shëndetësisë kishte efekt dhe u zbatua edhe nga Ndermarrja jone duke nxjerrur dhe zbatuar me përpikmëri vendimin me nr prot.02/1519 dt:11.08.2025 mbi masat mbrojtese, ku te gjithe të punësuarit e diagnostifikuar sipas shtojces se vendimit të ministries me diagnozat përkatëse sjellen dokumentet mbështetëse ne ZBNJ dhe u liruan nga procesi I punes sipas kërkesave ligjore nga vendimet e lartcekura. Punëtorët janë të evidentuar si më poshtë:

1. Njexhmije Sllovinja.
2. Shqipe Durmishi .
3. Sabahate Zeqiraj.
4. Lendita Dervishi.
5. Alboneta Krasniqi.
6. Fatlinda Kongjeli .
8. Shpresa Ismajle .
9.Lirije Krasniqi .
10.Florije Krasniqi.
11.Lulzim Haziri .
10. Marigona Ademaj .

<u>Evidenca e orëve të punëve për përllogaritjen e pagës :</u>

Për muajin korrik 2025:

- Evidenca e orëve të punëve konkretisht listat e orëve të punës për të gjithë punëtoret e SAP në këtë muaj janë përmbyllur në dt.30.07.2025. Verifikimet lidhur me respektimin e orarit paraprak,mungesat e ditëve pas përmbylljes së karnetës zbatohen në muajin vijues. Evidenca e orëve të punës si dhe pasqyrimi i mungesave eventuale , pushimeve janë evidentuar (karneta ) për sektorin e Operativës ëshhtë evidentuar me nr.02/1391/3 dt.30.07.2025, Evidnca e Administratë është evidentuar me nr.02/1391 dt:30.07.2025, ndërsa lista e shujtës së ngroht mbanë numrin 02/1391/1 dt:30.07.2025, si dhe lista e mungesave me arsyetim nga Drejtori Shpetim Aliu, me nr prot:02/1391/2 dt:30.07.2025.

Ndërsa për muajin gusht 2025:

- Evidenca e orëve të punëve konkretisht listat e orëve të punës për të gjithë punëtoret e SAP në këtë muaj janë përmbyllur në dt.29.08.2025. Verifikimet

lidhur me respektimin e orarit paraprak, mungesat e ditëve pas përmbylljes së karnetës zbatohen në muajin vijues. Evidenca e orëve të punës si dhe pasqyrimi i mungesave eventuale , pushimeve janë evidentuar (karneta ) për sektorin e Operativës ëshhtë evidentuar me nr.02/1722/1 dt.29.08.2025, Evidnca e Administratë është evidentuar me nr.02/1722 dt:29.08.2025, ndërsa lista e shujtës së ngroht mbanë numrin 02/1722/3 dt:29.08.2025.

Ndërsa për muajin shtator 2025:

- **Evidenca e orëve të punëve për përllogaritjen e pagës për muajin Shtator 2025**. Evidenca e orëve të punëve konkretisht listat e orëve të punës për të gjithë punëtoret e SAP në këtë muaj janë përmbyllur në dt.29.09.2025.

Verifikimet lidhur me respektimin e orarit paraprak,mungesat e ditëve pas përmbylljes së karnetës zbatohen në muajin vijues.Evidenca e orëve të punës si dhe pasqyrimi i mungesave eventuale , pushimeve janë evidentuar (karneta ) për sektorin e operativës është evidentuar me nr.02/2049 dt.29.09.2025. Evidnca e administratë është evidentuar me nr.02/2049/1 dt:29.09.2025, ndërsa lista e shujtës së ngroht mbanë numrin 02/12049/2 dt:29.09.2025.

### 5.3. Zyra e Marketingut dhe Shitjest

**Aktivitete dhe rezultatet**

Zyra e Marketingut dhe Shitjes, gjatë periudhë TM-III, 2025, ka vazhduar me përmbudhjen e detyrave dhe përgjegjësive gjatë kësaj periudhe, stafi i zyres së Marketingut dhe Shitjes, ka zhvilluar një punë të pa ndërprë dhe profesionale, me qëllim të arritjes së objetivave të ndërmarrjes.

Bazuar në të dhënat e arkivuara, në këtë periudhë janë nënshkruar:

- 8 marrëveshje për marketing
- 3 marrëveshje bashkëpunimi me operatorë ndërkombëtar
- 12 marrëveshje bashkëpunimi me operatorë ndërurbane
- 14 marrëveshje bashkëpunimi për shfrytëzimin e hapësirave të ndërmarrjes

## 6 Drejtoria e Operativës

### 6.1. Shërbimi i transportit

Shërbimi i transportit ka për qëllim ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për Operatorët Transportues që realizojnë nisjet ndërurbane dhe ndërkombëtare nga "Stacioni i Autobusëve" Prishtinë.

Në vijim është paraqitur raporti i Shërbimit të Transportit dhe numri i nisjeve për muajin korrik-shtator

Për ketë përudhë kohore janë realizuar gjithsejte 35,627 nisje, prej te cilave:

1. 28,288 nisje nder-urbanë:
2. 6,767 nisje ndërkombëtare, dhe

3. 572 vozitje te lira, turistike

Në raport me vitin e kaluar, vërehet një trend në rritje i nisjeve ndërkombëtare.

6.1.2. Numri i përgjithshëm i nisjeve te realizuara për kuartalin e dyte të vitit 2025

**Ndërmarja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A Prishtinë**

**Raport i realizimit të nisjeve ndërurbane dhe ndërkombëtare për vitin 2025**

| # | Destinacionet | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Ndërurbane** | JANAR | SHKURT | MARS | PRILL | MAJ | QERSHOR | KORRIK | GUSHT | SHTATOR | TETOR | NENTOR | DHJETOR | Total |
| 1 | Dobrajë | | | | | | | 243 | 200 | 246 | | | | 689 |
| 2 | Ferizaj | | | | | | | 1430 | 1367 | 1372 | | | | 4,169 |
| 3 | Gadime | | | | | | | 286 | 272 | 276 | | | | 834 |
| 4 | Gjakovë | | | | | | | 651 | 632 | 642 | | | | 1,925 |
| 5 | Gjilan | | | | | | | 1084 | 1047 | 1073 | | | | 3,204 |
| 6 | Istog | | | | | | | 425 | 412 | 413 | | | | 1,250 |
| 7 | Janjevë | | | | | | | 50 | 47 | 48 | | | | 145 |
| 8 | Kraishtë | | | | | | | 108 | 97 | 118 | | | | 323 |
| 9 | Lipjan | | | | | | | 306 | 287 | 290 | | | | 883 |
| 10 | Magure | | | | | | | 114 | 107 | 110 | | | | 331 |
| 11 | Malishevë | | | | | | | 266 | 252 | 244 | | | | 762 |
| 12 | Mitrovicë | | | | | | | 705 | 543 | 546 | | | | 1,794 |
| 13 | Orllan | | | | | | | 1 | 2 | 0 | | | | 3 |
| 14 | Pejë Deçan | | | | | | | 1052 | 1036 | 1031 | | | | 3,119 |
| 15 | Podujeve | | | | | | | 33 | 24 | 18 | | | | 75 |
| 16 | Prizren | | | | | | | 1027 | 1014 | 994 | | | | 3,035 |
| 17 | Rahovec | | | | | | | 469 | 452 | 450 | | | | 1,371 |
| 18 | Shalë | | | | | | | 390 | 378 | 371 | | | | 1,139 |
| 19 | Shtime | | | | | | | 0 | 0 | 0 | | | | - |
| 20 | Skenderaj-Drenas | | | | | | | 1023 | 928 | 1067 | | | | 3,018 |
| 21 | Sllovi | | | | | | | 76 | 70 | 73 | | | | 219 |
| 22 | Vozitje e lire | | | | | | | 193 | 255 | 124 | | | | 572 |
| | **Gjithsejt linjat** | - | - | - | - | - | - | 9,932 | 9,422 | 9,506 | - | - | - | 28,860 |
| | **Ndërkombëtare** | JANAR | SHKURT | MARS | PRILL | MAJ | QERSHOR | KORRIK | GUSHT | SHTATOR | TETOR | NENTOR | DHJETOR | Total |
| 23 | Austri | | | | | | | 127 | 132 | 111 | | | | 370 |
| 24 | Belgjikë | | | | | | | 9 | 9 | 8 | | | | 26 |
| 25 | Beograd | | | | | | | 154 | 154 | 149 | | | | 457 |
| 26 | Budva | | | | | | | 7 | 5 | 10 | | | | 22 |
| 27 | Bujanoc | | | | | | | 58 | 57 | 55 | | | | 170 |
| 28 | Danimark | | | | | | | 0 | 0 | 0 | | | | - |
| 29 | Diber | | | | | | | 23 | 20 | 22 | | | | 65 |
| 30 | Gjermani | | | | | | | 222 | 589 | 280 | | | | 1,091 |
| 31 | Herceg Novi | | | | | | | 0 | 0 | 0 | | | | - |
| 32 | Gostivare | | | | | | | 29 | 30 | 29 | | | | 88 |
| 33 | Itali | | | | | | | 40 | 73 | 50 | | | | 163 |
| 34 | Kotor | | | | | | | 26 | 31 | 30 | | | | 87 |
| 35 | Luksemburg | | | | | | | 4 | 5 | 2 | | | | 11 |
| 36 | Medvegj | | | | | | | 0 | 0 | 0 | | | | - |
| 37 | Novi Pazar | | | | | | | 57 | 56 | 57 | | | | 170 |
| 38 | Novi Sad | | | | | | | 0 | 0 | 0 | | | | - |
| 39 | Podgorice | | | | | | | 24 | 25 | 20 | | | | 69 |
| 40 | Preshevë | | | | | | | 85 | 81 | 81 | | | | 247 |
| 41 | Shkup | | | | | | | 214 | 220 | 208 | | | | 642 |
| 42 | Shqipëri | | | | | | | 576 | 572 | 558 | | | | 1,706 |
| 43 | Slloveni | | | | | | | 82 | 115 | 83 | | | | 280 |
| 44 | Struge | | | | | | | 51 | 58 | 52 | | | | 161 |
| 45 | Suedi | | | | | | | 7 | 18 | 5 | | | | 30 |
| 46 | Tetovë | | | | | | | 105 | 93 | 110 | | | | 308 |
| 47 | Turqi | | | | | | | 34 | 51 | 28 | | | | 113 |
| 48 | Ulqin | | | | | | | 59 | 49 | 48 | | | | 156 |
| 49 | Zagreb-Pulla | | | | | | | 53 | 57 | 49 | | | | 159 |
| 50 | Zvicerr | | | | | | | 49 | 81 | 46 | | | | 176 |
| | **Gjithsejtë linjat ndërkombëtare** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2095 | 2581 | 2091 | 0 | 0 | 0 | 6,767 |
| | **Gjithsejtë linjat** | - | - | - | - | - | - | 12,027 | 12,003 | 11,597 | - | - | - | 35,627 |

6.1.3. Krahasimi i nisjeve te realizuara ne 5 vitet e fundit 2020/2024




6.1.4. Karahsimi i numrit të biletave të udhëtimit të shituara 2024/2025

Për ketë përudhë kohore është realizuar shitja e gjithsejte 5,037. Kjo rënie e biletave është edhe për shkakun se gjate muajit Maj nuk ka pas sistem për shitjen e biletave te udhëtimit.




## 6.2. Raporti i punës për Shërbimin Teknik mirëmbajtja teknike

Ne kuadër te shërbimit teknik janë kryer punët e rregullta qe ndërlidhen me mirëmbajtjen dhe higjienën.

Me datën 15 korrik dhe 29 gusht 2025 me kërkese të Drejtorit te Operatives është bëre pastrimi gjeneral i hapësirave të jashtme me autobote (cisterna) uji të hapësirave të jashtëm dhe rreth peronave

Me datën 15 korrik dhe 29 gusht 2025 me kërkese të Drejtorit te Operatives është bëre pastrimi gjeneral i hapësirave të jashtme me autobote (cisterna) uji të hapësirave të jashtëm dhe rreth peronave.






Me datën 22 korrik 2025 ka filluar rikonstruktimi i fontanes e cila prite te perfundoj me daten 15 shtator nga NPL Ndermarja Publike Banesore sh.a




Me datën 25 korrik 2025 kanë filluar punimet në riparimin e asfaltit nga NPL Ndermarja Publike Banesore sh.a




Me 15 korrik ka filluar instalimi i rrjetit për ndriçim dhe vendosja e shtyllave të reja në kuadër të marrëveshjes me kabinetin e kryetarit të kryeqytetit. Fatkeqësisht, ky projekt ende nuk është përfunduar në ditën e përpilimit të këtij raporti. Janë përfunduar instalimet për 20 shtylla të reja dhe janë vendosur 9 sosh. Presim që në periudhën e ardhshme të vendosen edhe 11 shtylla të reja dhe te funksinalizohen shtyllat ndriçuese me poçet adekuat





Gjithashtu, në muajin korrik janë riparuar ulëset për pritje të udhëtareve





Gjatë muaji gusht, është bëre mbjellja e luleve dhe mirëmbajtja e parqeve.






Gjatë muaji gusht, dhe pas pranimit të punëtorëve te ri të pastrimit është bëre pastrimi gjeneral i hollit të pritjes së udhëtareve.






Gjate muajit shtator janë kryer pune dhe veprime ne drejtim te mirëmbajtjes se objektit dhe hapësirave gjelbëruese.

Është bere lyerja e rrethojës dhe peronave me ngjyra bardh dhe kaltër.




Është bere lyera e disa zyrave dhe hollit te pritjes



Gjatë muajit shtator është funksionalizuar fontana dhe ka fillu krasitja e pemëve.




Galaxy A16





## 7 Drejtoria e Shërbimeve të Përbashkëta

### 7.1. Sigurimi

Në zyrën e Sigurimit që përfshin Sigurimin e Administratës , Punëtorët e Sigurimit dhe Mbikëqyrësin e Kamerave, gjatë periudhës tre mujore Korrik -Shtator puna është zhvilluar në bazë te përgjegjësive dhe punëve te përcaktuara të punëtorëve.
Kërkesa për marrjen e pamjeve në zyrën e mbikëqyrësit të kamerave nga ana e Zyrtarëve policor gjatë kësaj periudhe kanë qenë pesë të cilat janë përcjellur në bazë te Shënimeve Zyrtare dhe procedurave të përcaktuara.
Është përcjellur kërkesa në zyren e Prokurimit për fillimin e procedurave për zbatimin e Planit Buxhetor ku parashihet, furnizimi me kamera dhe mjete përcjellëse e cila pritet të përmirësoj gjendjen e sigurisë së përgjithshme në ndërmarrjen Stacioni i Autobusëve.
Raportet e hyrjeve daljeve janë pranuar me rregull çdo ditë të cilat janë percjellur tek zyra e Burimeve Njerëzore dhe Drejtori i Administratës.
Raporti i qëndrimit të Autobusëve gjatë natës në parking është percjellur çdo ditë në mënyrë të rregullt tek koordinatorët nga Zyra e Sigurimit. Numri i autobusëve që kanë qëndruar në parking gjatë natës për këtë tremujor ka qenë 1711.
Në orarin e punës paradite është bashkangjitur një punëtor i Sigurimit .
Gjendja e përgjithshme e sigurisë në ndërmarrje përcillet nga Sigurimi i Administratës dhe punëtorët e Sigurimit të cilët raportojnë te përgjegjësi i sigurimit dhe dërgohen raporte javore në Drejtorin e Shërbimeve të Përbashkëta.

### 7.2. Zyra e IT-së

Në periudhën 3 mujore Korrik- Shtator në Zyrën e TI puna është zhvilluar kryesisht nga tekniku i TI. Puna është zhvilluar në bazë të kërkesave nga stafi për asistimin në problem teknike me pajisjet elektronike.
Gjatë muajve Korrik-Gusht-Shtator në bazë të raportit parapagimeve mujore pagesa kanë qenë 1094 pagesa.
Duke u bazuar në planifikimin buxhetor janë përcjellur specifikat për furnizim me paisje për TI në zyren e Prokurimit për të filluar procedurat e përkatëse .
Problemet në fushën e TI gjatë këtyre muajve kanë qenë kryesisht të natyrës teknike të cilat janë zgjidhur me ndërhyrje të shpejtë.

### 7.3. Zyra për Mbarëvajtjen e Proceseve të punës

Zyra për mbarëvajtjen e proceseve të punës ka monitoruar proceset e përgjithshme në Ndërmarrje duke dhënë vërejtje dhe rekomandime me Raporte javore. Janë monitoruar proceset e përgjithshme në Ndërmarrje duke dhëne Vërejtjet dhe sugjerimet e nevojshme

Zyrtari për Mbarëvajtjen e Procesit të punës ka qenë pjesë e komisionit për Verifikimin e gjendjes aktuale të Klimave në Ndërmarrje. Në bazë te këtij Raportit ku është vlerësuar gjendja e përgjithshme e klimave dhe nevoja për furnizim me klima të reja duke u bazuar edhe në Planifikimin e Buxhetit për vitin 2025 janë përcjellur specifikimet teknike dhe kërkesa për fillimin e Procedurave të Prokurimit në zyren e prokurimit. Furnizimi me këto klima do të ketë efekt pozitiv në disa aspekte duke ndikuar edhe në zvogëlim të shpenzimeve elektrike të Ndërmarrjes.
Me Vendim të Drejtorit të Administratës janë kryer inspektime në pagesa tek laurat të cilat ishin në përputhje me Sistem dhe me vërejtjet përkatëse është përcjellur Raporti.
Në Ndërmarrje ka pasur procese pozitive si kositja e barit, krasitja e pemëve , funksionalizimi i fontanës , mbjellja e luleve , lyerja e peronave, lyerja e Hollit, lyerja e disa zyrave të Administratës.
Planifikohet që në muajt e ardhshëm pas vendosjes së prioriteteve të vazhdohet me projekte të cilat janë te parapara në buxhetin e Ndërmarrjes për të përmirësuar infrastrukturën dhe nevojat e Ndërmarrjes.

## 8 Prokurimi

Në periudhën e **(TM-III-të)tremujorit të tretë të vitit 2025**, Zyra e Prokurimit ka zhvilluar gjithsej **10 (dhjetë)** procedura dhe aktivitete të prokurimit me vlera të përgjithshme prej:

1. Furnizim me Material Higjenik — Çmimi 1,436.90€
2. Furnizim me Material Administrativ, printim dhe dizajn — Çmimi 3,039.65€
3. Firnizim me Derivate Çmimi për Premium (Naftë dhe benzin 0.09Prem. — Çmimi 0.018€
4. Furnizim Me Paisje për IT(PC, Monitor ,Llaptop, Printer skaner) — Në proces
5. Furnizim me Material për mirëmbajtjen e Hollit dhe Peroneve — Çmimi 525.80€
6. Furnizimi dhe Montimi me Klima (Inverter) — Në Shqyrtim
7. Furnizim me Pajisje për Mirëmbajtjen hapësirave gjelbëruese — Anulim i tenderit
8. Furnizimi dhe Montimi me Pajisje për Vëzhgim;(Kamera,DVR,HDD) — Çmimi 1,899.00€
9. Matje-Atesti i rezistencës së Tokëzimit dhe Rrufepritësit — Çmimi 645.00€
10. Konkurs për Projektin e Marketingut për Stac.e Autobusëve në Prishtinë — Në proces

Aktivitetet e prokurimit përfshinë: **10 Procedura**

- **8(tetë** ) Procedura e Kuotimit të çmimit me vlerë të vogël;
- **2(Dy)** Procedura e Kuotimit me vlerë minimale
- **1(Një)** Anulim të tenderit me Vl.minim.(ska Ofertues)

# 9 Marrëdhëniet me publikun

Informimi i rregullt përmes rrjeteve sociale

Këtu janë disa nga mënyrat që përdorim për informim:

1. Publikimi i informacioneve – Shpërndarja e lajmeve dhe informacionit të nevojshëm.
2. Komunikata për shtyp – ku ndajme informacionin me publikun për ngjarje të rëndësishme.
3. Informimi për veprimtaritë e SAP – Përdorimi i rrjeteve sociale për të njoftuar për aktivitetet që po zhvillohen.
4. Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm – Shpërndarja e informacionit brenda dhe jashtë organizatës.
5. Publikime në faqe interneti dhe rrjete sociale – Vendosja e informacionit në faqe dhe rrjete sociale për të arritur më shumë njerëz.
6. Tabela informative – Përdorimi i tabelave për informim të brendshëm të punonjësve.

Platforma online, mediat sociale– Ku klientët mund të bëjnë pyetje dhe ne u përgjigjemi në kohë reale përmes Facebook, Messenger dhe Instagram

Konkurset janë shpërndarë në uebfaqen zyrtare te SAP dhe në platformat më të përdorura për punësim, përfshirë: KosovaJob, LypPune, Puna Ime dhe Oferta Pune.

ZMP ka bërë publikimin e të gjitha aktiviteteve, punëve dhe informatave në interes të bashkëpunëtorëve dhe qytetarëve.

**Në Uebfaqen zyrtar të SAP janë publikuar informacione të rëndësishme, përfshirë konkurset:**

1. Konkurs: Zyrtar kryesor financiar dhe i thesarit, 14.07.2025
2. Perkthimi i konkursit per ZKFTH, 14.07.2025
3. Raporti i hulumtimit Matja e kenaqshmerise se konsumatoreve Janar-Dhjetor 2024, 13.08.2025
4. Konkurs: Biletar, Dispeçer i peronave, Koordinator i ndërrimit, Nepunës në gardërobë, Punëtor në mirëmbajtje të objekteve dhe aseteve, 11.09.2025
5. Konkurset e përkthyera në gjuhën serbe

**Përveç detyrave të përditshme, gjatë këtyre muajve janë realizuar edhe këto angazhime:**

1. Lista e përfituesve te telefonis VALA
2. ID kartelat për Hyrje-Dalje për koleget e punësuar
3. Anëtarë e Komisionit për trajtimin e ankesave të punëtorëve kundër vendimeve të punëdhënësit, rasti i Shefki Rexhepit 03.07.2025
4. Anëtarë e komisionit për " Furnizim me derivate", 15.07.2025
5. Menaxhere e projektit: Furnizim me material administrativ NPL.St.AUT 25-6002-1-3-6, 29.07.2025
6. Informimi i punëtoreve për masat mbrojtëse nga temperaturat e larta, te rekomanduara nga IKSHPK, Korrik-Gusht 2025
7. Këndi i dhuratave
8. Ekskursioni ne Shqipëri.

# 10 Zyrtarë për Planifikim, Zhvillim dhe Koordinim

Ky raport përmbledh punën e realizuar nga Zyra për Planifikim, Zhvillim dhe Koordinim gjatë periudhës Korrik – Shtator 2025. Raporti është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara për këtë tremujor dhe përfaqëson një pasqyrë të detajuar të proceseve, projekteve dhe angazhimeve në të cilat ka qenë e përfshirë zyra gjatë kësaj periudhe.

Në këtë kuadër, në vijim paraqitet raporti im i punës për muajt Korrik, Gusht dhe Shtator 2025, i cili përfshin aktivitetet kryesore, detyrat e realizuara, sfidat e hasura dhe rezultatet e arritura në kuadër të përgjegjësive të mia si Zyrtar për Planifikim, Zhvillim dhe Koordinim.

## 10.1. Aktivitetet dhe rezultatet e arritura gjatë periudhës korrik – shtator 2025

Fillimisht, gjatë kësaj periudhe, me kërkesë të menaxhmentit të lartë, Zyra për Planifikim, Zhvillim dhe Koordinim ka hartuar raporte krahasuese ndërmjet të dhënave të matjeve të hapësirave afariste të vitit 2019 dhe atyre të vitit 2025. Qëllimi kryesor i këtyre raporteve ka qenë evidentimi i ndryshimeve teknike dhe pasqyrimi i gjendjes reale të hapësirave afariste.

Ndërkohë, si një nga arritjet kryesore të kësaj periudhe duhet theksuar fakti që, falë angazhimit të Zyrës për PZHK si iniciuese dhe menaxher i procesit, në raportin e vitit 2025 janë përfshirë gjithsej **35 hapësira afariste dhe 6 sportele**, me një sipërfaqe të përgjithshme prej **7,396.57 m²**, krahasuar me raportin e vitit 2019 ku ishin evidentuar vetëm 30 njësi me gjithsej **4,901.73 m²**.

Nga krahasimi njësi më njësi, sipërfaqja totale ka kaluar nga **4,901.73 m² në vitin 2019** në **5,317.09 m² në vitin 2025**, që paraqet një rritje prej **415.36 m²** ose rreth **8.5%**. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i saktësimit të matjeve ekzistuese, por edhe nga përfshirja më e qartë e sipërfaqeve ndihmëse, si p.sh. terasat. Pra, nga ky krahasim del të kemi këtë pasqyrë:

- 17 hapësira kanë rezultuar me rritje të sipërfaqes,
- 8 hapësira me zvogëlim minimal, më të vogël se 0.5m² (ku më e theksuara është hapësira nr. 24),
- ndërsa 5 hapësira kanë mbetur të pandryshuara.

Qëllimi kryesor i këtyre raporteve ka qenë evidentimi i ndryshimeve teknike dhe pasqyrimi i gjendjes reale të hapësirave afariste. Raportet e përgatitura nga Zyra për PZHK, janë prezantuar edhe nga vet unë tek Bordi i Drejtorëve.

Në vijim të punëve gjatë kësaj periudhe, përveç procesit të Incizim Matjes së Hapësirave Afariste, kam qenë edhe iniciues i projektit për vlerësimin e tokës, objekteve dhe hapësirave afariste të ndërmarrjes në SAP. Krahas rolit të iniciuesit, kam ushtruar edhe funksionin e menaxherit të projektit, ku kam siguruar të gjitha të dhënat e nevojshme për Operatorin Ekonomik, duke mundësuar realizimin e plotë të procesit të vlerësimit.

Nga ky proces ndërmarrja ka pranuar gjithsej tre raporte zyrtare të vlerësimit, të cilat përbëjnë bazën kryesore për administrimin dhe menaxhimin e mëtejmë të pasurisë:

I. Raporti për vlerësimin e tokave,
II. Raporti për vlerësimin e objekteve ndërtimore,
III. Raporti për vlerësimin e qirasë së tregut/analizë.

Këto dokumente janë rezultat i punës së Operatorit Ekonomik dhe janë siguruar me të gjitha të dhënat e nevojshme nga ana ime, në cilësinë e menaxherit të projektit. Në vijim po paraqes disa përftime nga këto raporte:

### 10.2. Raporti mbi Vlerësimin e Tokave - 001

Raporti për tokat ka përcaktuar një vlerë të drejtë prej rreth 19 milionë euro, që shënon rritje të konsiderueshme krahasuar me vlerësimin e mëparshëm dhe reflekton zhvillimin e zonës ku ndodhet ndërmarrja.

### 10.3. Raporti mbi Vlerësimin e Objekteve Ndërtimore - 002

Raporti për objektet ndërtimore ka përcaktuar vlerën e drejtë për objektin qendror dhe garazhin, duke ofruar një pasqyrë të qartë të gjendjes së tyre dhe të shkallës së amortizimit. Për objektin kryesor është përcaktuar një vlerë e drejtë prej 1,318,162.41 €, me jetë ekonomike të parashikuar 50 vjet, jetë efektive 20 vjet dhe shkallë amortizimi 40%. Ndërsa për objektin e garazhës është dhënë një vlerë prej 93,877.68 €, me jetë ekonomike 50 vjet, jetë efektive 24 vjet dhe amortizim 48%.

### 10.4. Raporti mbi Vlerësimin e qirasë së tregut/Analizë - 003

Në vazhdim, rëndësi të veçantë i është dhënë raportit për vlerësimin e qirasë mujore për hapësirat afariste, pasi këto hapësira përbëjnë një nga faktorët kyç në sigurimin e të hyrave të ndërmarrjes përmes procesit të qirasë. Ky raport ka shërbyer për të përcaktuar vlerën reale të qirasë së tregut për çdo kategori hapësire, ku ndarja është bërë në katër njësi kryesore: lokale, terasa të brendshme, terasa të jashtme dhe tokë.

Nga Zyra për PZHK, si përpiluese e specifikacionit teknik për projektin "Vlerësimi i Pronave të Paluajtshme & Vlera e Qirasë së Tregut", është paraparë si kërkesë që Operatorit Ekonomik t'i ngarkohet detyrimi për të bërë kategorizimin e hapësirave afariste, si dhe përcaktimin e çmimit minimal, mesatar dhe maksimal për secilën hapësirë afariste. Nisur nga kjo kërkesë, është realizuar kategorizimi në gjashtë kategori dhe përcaktimi i çmimeve përkatëse, të cilat paraqiten në vijim në tabelat e mëposhtme.

| A | B | C | D | E | F |
|---|---|---|---|---|---|
| Shumë e mirë | E mirë | Mesatare | Pjesërisht | Jo e mirë | E dobët |

Në vijim, sipas raportit të vlerësimit të vitit 2025, paraqitet edhe **çmimi i përcaktuar për qira për secilën kategori** – për lokalet, terasat e brendshme, terasat e jashtme dhe tokën.

| Kategoria | Çmimi mesatar | Sipërfaqja në m² | Kuota midis kategorive | Sipërfaqja e lokalit | Qiraja mujore për m² | Qiraja mujore |
|---|---|---|---|---|---|---|
| A | 25.00€ | 1 - 10 m² | 140% | | | |
| B | 20.04€ | 11 - 30 m² | 100% | | | |
| C | 15.95€ | 31 - 60 m² | 80% | | | |
| D | 14.00€ | 61 - 120 m² | 65% | | | |
| E | 13.33€ | 121 - 300 m² | 50% | | | |
| F | 10.63€ | 301 - 1000 m² | 37% | | | |

Vlera e qirasë për metër katror për terrasat e jashtme dhe të brendshme, në kategorinë A, është propozuar si më poshtë:

| Përshkrimi | Çmimi për m² | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Kategoria | Mesatar | Minimal | Maksimal |
| Terasa e jashtme | [redacted] | 2.25€ | 1.50€ | 3.00€ |
| Terasa e brendshme | [redacted] | 2.50€ | 1.75€ | 3.50€ |

Vlera e qirasë për metër katror për terrasat e jashtme dhe të brendshme, në kategorinë B, është propozuar si më poshtë:

| Përshkrimi | Çmimi për m² | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Kategoria | Mesatar | Minimal | Maksimal |
| Terasa e jashtme | B | 1.00€ | 0.75€ | 1.50€ |
| Terasa e brendshme | B | 1.50€ | 1.00€ | 2.00€ |

Ndryshe nga raporti i vitit 2019, në vlerësimin e vitit 2025, tokat nuk janë kategorizuar sipas ndonjë kriteri klasifikues, por për to është përcaktuar një çmim i veçantë, i cili është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

| Përshkrimi | Çmimi për m² | | |
|---|---|---|---|
| | Mesatar | Minimal | Maksimal |
| Toka me qira | 0.75€ | 0.50€ | 1€ |

Nga kategorizimi i bërë nga Operatorit Ekonomik, ndërmarrja ka fituar një pasqyrë më të qartë mbi ndarjen e hapësirave afariste, gjë që ka ndihmuar edhe në përcaktimin e vlerës së qirasë për metër katror. Ndryshe nga raportet e mëparshme, tani sa i përket lokaleve, janë kategorizuar gjithsej 11 lokale në kategorinë A, 15 lokale në kategorinë B, 3 lokale në kategorinë C, 3 lokale në kategorinë D, si dhe nga një lokal në kategoritë E dhe F. Sa i përket terasave të brendshme, janë përfshirë 3 terasa në kategorinë A dhe 7 terasa në kategorinë B, ndërsa tek terasat e jashtme kemi 11 të kategorizuara në kategorinë A dhe 6 në kategorinë B. Sigurisht, të gjitha këto ndryshime, si në aspektin e kategorizimit ashtu edhe në përcaktimin e çmimit të qirasë, do t'i sjellin ndërmarrjes përfitime të drejtpërdrejta në buxhet, duke krijuar një bazë më të qëndrueshme financiare dhe një menaxhim më transparent të hapësirave afariste.

Pas pranimit të raporteve nga Operatorit Ekonomik, Zyra për PZHK ka dhënë një shpjegim të detajuar mbi ndikimin që këto dokumente do të kenë në administrimin e hapësirave afariste, me theks të veçantë në aspektin financiar. Në këtë vazhdë, Zyra ka kryer krahasimin e çmimeve për secilën njësi, duke analizuar ndryshimet ndërmjet vlerësimeve të bëra në vitin 2019 dhe atyre të vitit 2025.

Ndërkohë, me kërkesë të menaxhmentit, janë përgatitur edhe raporte shtesë që lidhen me përcaktimin e vlerës së qirasë për hapësirat afariste, të cilat janë dorëzuar me kohë tek njësia kërkuese, gjithmonë në përputhje me kërkesat e paraqitura.

Zyra për PZHK i ka prezantuar këto raporte edhe para Bordit të Drejtorëve, i cili pas shqyrtimit i ka miratuar: Raportin për incizim dhe matjen e hapësirave afariste të SAP-it (nr.prot. 02/883, datë 29.05.2025) dhe Raportin mbi vlerësimin e qirasë/analizë (nr.prot. 02/1268/2, datë 11.07.2025). Në vijim, mbi bazën e tyre është bërë përcaktimi i vlerës së re të qirasë për metër katror për secilën hapësirë.

Pas kësaj, Zyra për PZHK ka përgatitur Vendimin dhe Rregulloren për plotësim/ndryshim të Rregullores bazë për qiratë, ku janë inkorporuar të dhënat e këtyre raporteve. Si bazë për vlerësimin e hapësirave afariste është marrë raporti i pavarur i kryer nga vlerësuesi i licencuar OE "Pro Acc Group", i angazhuar nga menaxhmenti i ndërmarrjes në vitin 2025 (nr.prot. 02/1268/2, datë 11.07.2025). Ndërsa për matjen e sipërfaqeve të hapësirave afariste është përdorur raporti profesional i OE "Gjeo Projekt", i realizuar po ashtu në vitin 2025 (nr.prot. 02/883, datë 29.05.2025). Vlen të theksohet, se për bazë është marrur vlera mesatare në të gjitha njesit.

Duke pasur tashmë bazën ligjore të konsoliduar për vazhdimin e procedurave, Zyra për PZHK ka hartuar njoftimin mbi kushtet dhe kriteret e reja për vazhdimin e kontratave të hapësirave afariste, duke u mbështetur në çmimet e reja të miratuara dhe duke i adresuar Njoftimet individualisht për secilën hapësirë të shfrytëzuar nga qiramarrësit. Janë dërguar gjithsej 29 njoftime për qiramarrësit. Nga këto, 13 qiramarrës kanë paraqitur kundërshtime, ndërsa pjesa tjetër ka shprehur menjëherë interesim për vazhdimin e kontratave. Vlen të theksohet, se më pas 28 qiramarrës kanë pranuar kushtet e reja dhe kanë shprehur interesimin për vazhdimin e kontratave të reja për qiradhënie.

Zyra për PZHK ka përgatitur një raport të detajuar mbi këto kundërshtime, duke dhënë sqarime si mbi kërkesat e qiramarrësve, ashtu edhe mbi mënyrën se si është përcaktuar çmimi i qirasë për hapësirat afariste. Pas shqyrtimit të raportit në Bordin e Drejtorëve dhe vendimit për refuzimin e të gjitha kundërshtimeve, Zyra Ligjore ka përpiluar vendimin përfundimtar, duke lënë në fuqi njoftimin paraprak. Vlen të theksohet, se më pas 28 qiramarrës kanë pranuar kushtet e reja dhe kanë shprehur interesimin për vazhdimin e kontratave të reja për qiradhënie.

Më pas, Zyra për PZHK ka dhënë kontributin e saj edhe në komentet dhe sugjerimet për përpilimin e kontratave të reja për qiradhënie (për pjesët që i takojnë zyrës për PZHK), të cilat do të integrohen në kontratën bazë. Aktualisht, procesi ndodhet në fazën finale të nënshkrimit të kontratave.

Si përfundim, nga këto hapësira afariste që aktualisht janë të zëna me qiramarrës, ndërmarrja do të përfitojë një rritje të të hyrave mujore prej rreth 5,683.01€ (në rast se të gjithë qiramrrësit që kanë deklaruar se janë PËR nënshrkimin e kontratës lidhin marrëveshje me ndërmarrjen), duke forcuar stabilitetin financiar dhe duke siguruar një menaxhim më efikas të pasurisë së saj.

Paralelisht me këto procese, Zyra për PZHK ka dhënë kontributin e saj edhe në investimet e vazhdueshme që po realizohen në hapësirat e ndërmarrjes, me qëllim përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe udhëtarët që i shfrytëzojnë ato çdo ditë.

## 10.5. Objektivat për tremujorin e ardhshëm

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2025, Zyra për Planifikim, Zhvillim dhe Koordinim do të fokusohet në ndihmën e saj kur i kërkohet për finalizimin dhe nënshkrimin e kontratave të reja për qiradhënie, si dhe në implementimin praktik të tyre në terren. Paralelisht, do të përgatiten dhe dorëzohen propozimet për projektet që do të përfshihen në Planin e Biznesit 2026, me synim të zhvillimit të mëtejmë të ndërmarrjes dhe rritjes së të hyrave. Po ashtu, do të vazhdohet me kontaktet dhe bashkëpunimet me palë të tjera të interesuara për iniciativa të përbashkëta, ndërsa njëkohësisht do të bëhen përgatitjet administrative e organizative për hyrjen sa më të strukturuar në vitin 2026.

## 10.6. Përfundimi

Tremujori i tretë i vitit 2025 ka qenë një periudhë e mbushur me procese të rëndësishme dhe angazhime konkrete, ku Zyra për Planifikim, Zhvillim dhe Koordinim ka pasur rol kyç në përgatitjen e dokumenteve teknike, analizën dhe vlerësimin e hapësirave afariste, si dhe në përpilimin e vendimeve dhe rregulloreve që kanë ndikuar drejtpërdrejt në menaxhimin e hapësirave afarsite të ndërmarrjes.

Për shkak të angazhimit të lartë në procesin e administrimit të hapësirave afariste dhe finalizimit të kontratave të reja, disa nga aktivitetet e planifikuara për këtë periudhë nuk kanë mundur të realizohen brenda afatit të parashikuar. Megjithatë, zyra ka mbetur në kontakt të vazhdueshëm me Komunën e Prishtinës dhe me palë të tjera relevante, me qëllim të zhvillimit të iniciativave që lidhen me përmirësimin e infrastrukturës dhe sigurisë publike në zonën përreth stacionit.

Aktualisht, si Zyrë jemi në proces të përgatitjes së një kërkese drejtuar Komunës së Prishtinës për vendosjen e një ndriçuesi/sinjalizuesi në vijën e këmbësorëve, për të mundësuar që udhëtarët dhe qytetarët të kalojnë rrugën më sigurt, duke pasur një orientim dhe mbrojtje më të qartë gjatë lëvizjes së tyre pranë stacionit.

Në këtë tremujor janë arritur rezultate të prekshme, duke përfshirë miratimin e raporteve kryesore të vlerësimit dhe incizimit, përcaktimin e çmimeve të reja të qirasë, përfundimin e procesit të kundërshtimeve dhe hyrjen në fazën finale të nënshkrimit të kontratave të reja. Këto arritje kanë krijuar një bazë të fortë ligjore dhe financiare, e cila do të sjellë rritje të konsiderueshme të hyrave mujore të ndërmarrjes.

Ky zhvillim është rezultat i punës së përkushtuar të Zyrës për PZHK dhe mbështetjes së vazhdueshme të Kryeshefit Ekzekutiv, z. Prelvukaj. Qasja jonë mbetet praktike, e koordinuar dhe e fokusuar në rezultate, me synim që çdo proces i ndërmarrë të sjellë vlerë të shtuar për ndërmarrjen dhe qytetarët që shfrytëzojnë çdo ditë shërbimet e saj.

| | |
|---|---|
| Punoi: | Aprovoi: |
| U.D. Kryeshef Ekzekutiv | Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve |
| Veton R. PRELVUKAJ | Pajtim DEMAJ |
| ------------------------ | ------------------------ |

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë · NPE "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. / Autobuska Stanica A.D. / Bus Station J.S. — Pristina, Pristina, Prishtinë